

TERMAT E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE DHE PRIVATËSISË

Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) garanton mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale sipas ligjor në fuqi.

Mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe në aktet të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

QËLLIMI

Portali (Antikorrupsion ADISA) është një portal, i cili ju garanton të drejtën tuaj ligjore për të denoncuar çdo praktikë korruptive të evidentuar në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

PËRKUFIZIME

“*Praktikë korruptive*” është çdo veprim ose mosveprim i kryer nga punonjës të ADISA duke abuzuar me ushtrimin e funksionit/detyrës, me qëllim sigurimin e përfitimeve të paligjshme për interesa private.

“*Korrupsion*” është çdo veprim ose mosveprim i kundërligjshëm, sipas legjislacionit penal në fuqi, në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv, shpërdorimit të detyrës ose kompetencave, ushtrimit të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve, shpërdorimit të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përfitimit të paligjshëm të interesave, si dhe çdo akt tjetër i ngjashëm me to.

PARIMET

- Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.
- Përpunimi bëhet për qëllime specifike, të përcaktuara qartë dhe legjitime.
- Përpunimi i të dhënave bëhet vetëm për qëllimin për të cilën është krijuar ky portal (proporcionaliteti).
- Përpunimi bëhet në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe legjitime.

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Përpunimi i të dhënave Personale

ADISA përpunon të dhënat personale të qytetarëve, të cilët aksesojnë Portalin Antikorrupsion dhe plotësojnë të dhënat e kërkuara nga ky portal. Të dhënat e kërkuara nga portali përfshijnë emër, mbiemër, adresë, numër telefoni fiks apo celular, adresë emaili dhe çfarëdo lloj të dhëne tjetër kontakti.

Përpunimi i të dhënave sensitive

Ndalohet përpunimi i të dhënave sensitive.

ADISA mund të përpunojë të dhëna sensitive të cilat janë të lidhura me denoncimin. Përpunimi i këtyre të dhënave do të kryhet me pëlqimin e shprehur të denoncuesit, i cili mund të revokohet në çdo çast. Revokimi i pëlqimit e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave.

Të dhëna mbështetëse dhe vërtetuese

ADISA përpunon edhe të dhëna të cilat mbështesin dhe/ose vërtetojnë denoncimin. Këto të dhëna përfshijnë video, foto, dokumente dhe çdo format tjetër të cilat ngarkohen në portal si pjesë e denoncimit (ose si pjesë e formularit online të denoncimit).

Denoncuesi është përgjegjës për të gjitha të dhënat e dorëzuara, sipas legjislacionit në fuqi. ADISA nuk mban përgjegjësi për saktësinë, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e të dhënave të dorëzuara nga denoncuesi. Denoncuesi është përgjegjës për gjithë informacionet apo denoncimet e rreme, ato që mund të konsiderohen si shpifje, abuzive, kërcënuese, të dëmshme apo të pahijshme.

Ruajtja e të dhënave

Të dhënat personale do të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme sipas qëllimit kryesor të mbledhjes, në bazën e të dhënave të portalit WEB.

Shqyrtimi dhe Transferimi i të dhënave personale

Kryerja e denoncimit të një rasti korruptiv nënkupton edhe pëlqimin e denoncuesit për shqyrtimin e të dhënave personale dhe transferimin e tyre pranë institucioneve përgjegjëse për shqyrtim të mëtejshëm.

Nëse gjatë shqyrtimit të denoncimit konstatohet shkelje e detyrimeve apo konsumimi i një veprë penale, ADISA ka përgjegjësinë të transferojë të dhënat pranë organeve ligjzbatuese përgjegjëse për hetimin e rasteve.

Përdorimi i të dhënave personale për qëllime statistikore dhe/ose cilësore

Të dhënat tuaja personale të mbledhura nëpërmjet këtij portali, përpunohen në përputhje me qëllimin për të cilin ato mbledhen dhe në zbatim të kuadrit ligjor.

Të dhënat tuaja përpunohen nga ADISA edhe për qëllime statistikore dhe raportimi, në kuadër të analizimit të tyre, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Denoncimet Anonime

Ju keni të drejtë të denonconi një praktikë korruptive duke qëndruar anonim.

Në rastet e denoncimit anonim, në përmbajtje të denoncimit të vendoset, detyrimisht informacioni lidhur me:

- a) Objektin e denoncimit, përshkrim i shkurtër i praktikës korruptive;
- b) Pranimin e kushteve të përdorimit dhe politikës së privatësisë.

Në rast se ju nuk shënoni të dhëna kontakti në formularin elektronik në portal ADISA nuk do të ketë mundësi t'ju njoftojë lidhur me trajtimin e denoncimit apo masat që do të merren si rezultat i denoncimit tuaj.

AKSESI NË TË DHËNAT E DËRGUARA, KORRIGJIMI DHE FSHIRJA E TYRE

Në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ju keni të drejtën për të kërkuar informacion mbi përpunimin e të dhënave tuaja, korrigjimin dhe/ose fshirjen e tyre.

Kërkesa për informacion mbi përpunimin e të dhënave personale, korrigjim dhe/ose fshirje të të dhënave dërgohet me shkrim në adresën:

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)

Bulevardi. Zhan D’Ark, Ish Hoteli i Ushtarakëve, Kati VI.

Lutemi që, në kërkesë të bashkëlidhet edhe emri, adresa dhe një numër telefoni.

ADISA ka detyrimin që t’ju informojë mbi kërkesën tuaj brenda 30 ditëve nga depozitimi i saj.

Në rast shkelje të procedurave të mësipërme, keni të drejtën e ankimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

ANKIMI

Për çdo pretendim mbi shkeljen e të drejtave tuaja mbi përdorimin e të dhënave personale dhe privatësisë, mund të bëhet ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pas këtij ankimi, mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për Organizimin Dhe Funkcionimin E Gjykatave Administrative Dhe Gjykimin E Mosmarrëveshjeve Administrative”.